



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK KAMËZ

Nr. 164 prot.

Kamëz, më 19.12.2024

V E N D I M  
Nr. 120 Datë 19/12 2024  
M B I

“ SISTEMIN E TAKSAVE DHE TARIFAT VENDORE NË BASHKINË KAMËZ”

Këshilli Bashkiak Kamëz i mbledhur sot me datë 19.12.2024, pasi mori në shqyrtim projekt-vendimin Nr.90 Datë 10.12.2024 mbështetur në gërmën "P", të nenit 54 të Ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore"; Ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore, Ligjin nr. 9632 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar, VKM-në nr. 132, datë 07.03.2018 "Për metodologjinë për përcaktimin e vlerës së taksueshme të pasurisë së paluajtshme "ndërtesa"...., i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 32, datë 31.12.2013 "Për Tatimin e Thjeshtuar mbi Fitimin e biznesit të vogël", i ndryshuar, Ligjin nr.8438, datë 28.12.1998 Për Tatimin mbi të Ardhurat" i ndryshuar, Ligjin nr.9920, datë 19.05.2008 "Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Udhëzimit nr.24 datë 02.09.2008 Për Proçedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, Ligji nr. 9723, datë 03.05.2007 "Për qendrën Kombëtare të Regjistrimit", i ndryshuar Ligjin nr.10081, datë 23.02.2009 "Për Liçencat, Autorizimet dhe Lejet në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin nr.44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin Nr. 115/2014 "Për Ndarjen Administrative Territoriale të Njësive të Qeverisjes Vendore në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr.107/2014 datë 31.07.2014, "Për Planifikimin e Territorit" i ndryshuar, VKM nr.408 datë 13.05.2015, "Për Miratimin e Rregullores së Zhvillimit të Territorit" i ndryshuar, Ligjin nr. 9482 datë 03.04.2006 "Për Legalizimin Urbanizimin dhe Integrimin e Ndërtimeve pa Leje", i ndryshuar, Ligjin nr.10465, datë 29.09.2011 "Për Shërbimin Veterinar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Ligjin 152/2015 "Për Shërbimin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin", Ligjin nr.9385, datë 04.05.2005 "Për Pyjet dhe Shërbimin Pyjor", i ndryshuar, Ligjin nr.9693, datë 19.03.2007 "Për Fondin Kullosor" i ndryshuar, Ligjin 10279 datë 20.05.2010 "Për Kundravajtjet Administrative" Ligjin nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit, Ligjin nr. 10 433, datë 16.6.2011 "Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë", Ligjin nr. 9774, datë 12.07.2007 "Për administrimin dhe vlerësimin e zhurmës në mjedis", i ndryshuar; Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore; Këshilli Bashkiak Kamëz";

V E N D O S I:

1. Miratimin e Sistemit të Taksave dhe Tarifave Vendore në Bashkinë Kamëz për vitin 2025 sipas dokumentit bashkëlidhur.
2. Ky vendim hyn në fuqi pas konfirmimit ligjor nga Prefekti i Qarkut Tiranë.

KRYETAR KËSHILLI  
Hysen KOLDASHI

